

RREGULLORE

Për formën dhe përmbajtjen e shpalljes publike, paraqitjes për punësim dhe mënyrën e zbatimit të përzgjedhjes për punësimin e ofruesve të shërbimeve publike në Ndërmarrjen Publike për Furnizim me Ujë "Studënçica" - Kërçovë

Mars, 2026

Në bazë të nenit 37-e, 37-i, 37-j, 37-k, 37-l, 37-ll, 37-m, 37-nj të Ligjit për Ndërmarrjet Publike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 38/96, 9/97, 06/02, 40/03, 49/06, 22/07, 83/09, 97/10, 6/12, 119/13, 41/14, 138/14, 25/15, 6/15 dhe 39/16, 64/2018; 35/2019; 275/2019; 89/2022; 274/2022; 208/2024; 193/2025), nenit 26 paragrafi 17 të Statutit të NP "Studënçica" - Kërçovë dhe nenit 32 të Rregullores së punës së Këshillit Drejtues të ndërmarrjes, Këshilli Drejtues i NP "Studënçica" - Kërçovë miratoi këtë:

RREGULLORE

Për formën dhe përmbajtjen e shpalljes publike, paraqitjes për punësim dhe mënyrën e zbatimit të përzgjedhjes për punësimin e ofruesve të shërbimeve publike në Ndërmarrjen Publike për Furnizim me Ujë "Studënçica" - Kërçovë

Neni 1

(1) Me këtë rregullore rregullohet forma dhe përmbajtja e shpalljes publike, paraqitjes për punësim dhe mënyra e zbatimit të përzgjedhjes për punësimin e ofruesve të shërbimeve publike në Ndërmarrjen Publike për Furnizim me Ujë "Studënçica" - Kërçovë.

Neni 2

(1) Për zbatimin e procedurës për punësimin e ofruesve të shërbimit publik, Drejtori i Ndërmarrjes Publike për Furnizim me Ujë "Studënçica" - Kërçovë merr Vendim për plotësimin e vendeve të lira të punës përmes shpalljes së një konkursi publike.

Neni 3

(1) Për fillimin e procedurës për punësimin e ofruesit të shërbimit publik, drejtori i ndërmarrjes publike shpall konkurs publik, i cili publikohet në faqen e internetit të ndërmarrjes publike, si dhe në së paku tre gazeta ditore, prej të cilave njëra nga gazetate që botohen në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve që flasin një gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase.

Neni 4

(1) Shpallja publike për plotësimin e vendeve të punës të ofruesve të shërbimeve publike në Ndërmarrjen Publike për Furnizim me Ujë "Studençica" - Kërçovë përmban:

- për secilin vend pune të ndryshëm në shpallje: numrin rendor, kodin, emërtimin dhe numrin e zbatuesve;
- për secilin vend pune të ndryshëm në shpallje: kushtet e përgjithshme (në përputhje me ligjin dhe/ose marrëveshjen kolektive); kushtet e veçanta (arsimi, përvoja e punës, kompetencat e përgjithshme dhe të veçanta të punës si p.sh. njohja e një gjuhe të huaj, puna me kompjuter dhe kushte të tjera sipas aktit për sistematizimin e institucionit); dhe/ose kushte plotësuese, nëse ka nevojë (statusi i personit me nevoja të veçanta, statusi i fëmijës pa prindër dhe pa kujdes prindëror i cili deri në moshën e tij 18-vjeçare ka pasur këtë status, ose statusi i shfrytëzuesit të bursës shtetërore);
- për secilin vend pune të ndryshëm në shpallje: vendin e kryerjes së detyrave të punës, orarin e kohës së punës; fillimin dhe mbarimin e kohës ditore dhe javore të punës;
- për secilin vend pune të ndryshëm në shpallje: shumën neto në para të pagës;
- afatin për dorëzimin e paraqitjes për punësim;
- mënyrën dhe vendin ku duhet të dorëzohet paraqitja dhe dëshmitë e detyrueshme për plotësimin e kushteve të punësimit (duke treguar adresën e saktë);
- informacion të shkurtër mbi mënyrën e zbatimit të procedurës së përzgjedhjes (të identifikohen fazat, p.sh.: verifikimi i paraqitjes dhe dëshmime, testet, provimet, intervista dhe/ose forma të tjera për verifikimin e kandidatëve).

(2) Afati për paraqitje në shpalljen publike nga paragrafi (1) i këtij neni nuk mund të jetë më i shkurtër se 15 ditë, përkatësisht më i gjatë se 20 ditë nga dita e publikimit të tij në gazetën ditore.

Neni 5

(1) Kandidatët për plotësimin e vendit të punës së ofruesit të shërbimit publik në ndërmarrjen publike dorëzojnë paraqitje për punësim (e cila është dhënë në Shtojcën nr. 1 dhe është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje), në përputhje me kushtet e parapara në shpalljen për punësimin e ofruesit të shërbimit publik në Ndërmarrjen Publike për Furnizim me Ujë "Studençica" - Kërçovë.

(2) Kandidatët e interesuar mund ta shkarkojnë Paraqitjen për punësim nga ueb-faqja e Ndërmarrjes Publike për Furnizim me Ujë "Studençica" - Kërçovë ose nga Arkivi i ndërmarrjes publike.

(3) Paraqitja për punësim në vendin e punës përmban:

- të dhënat për shpalljen (numrin dhe datën e publikimit të shpalljes publike);
- të dhënat për vendin e punës (emërtimin dhe kodin e vendit të punës);
- të dhënat për kandidatin (emrin dhe mbiemrin, numrin amzë, datën dhe vendin e lindjes, adresën dhe vendbanimin, adresën elektronike të kandidatit, telefonin e kontaktit, përkatësinë komunitare);
- një letër të shkurtër motivimi;
- një biografi të shkurtër (CV);

- deklaratë për plotësimin e kushteve të përgjithshme për vendin e punës për secilin kusht veç e veç;
- deklaratë për plotësimin e kushteve të veçanta për vendin e punës për secilin kusht veç e veç;
- deklaratë me të cilën kandidati nën përgjegjësi morale dhe penale konfirmon se të dhënat në paraqitje janë të sakta, ndërsa dëshmitë e dorëzuara janë besnike ndaj origjinalit.

(4) Bashkëngjitur me paraqitjen, kandidatët detyrimisht duhet të bashkojnë dëshmitë e nevojshme për të dhënat e futura në të njëjtën, të cilat duhet të jenë në formë origjinale ose kopje e vërtetuar te noteri.

Neni 6

(1) Për zbatimin e procedurës për punësimin e ofruesve të shërbimit publik, Drejtori i Ndërmarrjes Publike për Furnizim me Ujë "Studençica" - Kërçovë me vendim formon Komisionin e përzgjedhjes për procedurën e punësimit të ofruesve të shërbimeve publike.

(2) Komisioni nga paragrafi (1) i këtij neni përbëhet nga:

- ofruesi i drejtpërdrejtë udhëheqës i shërbimit publik, i cili është kryetar i komisionit dhe zëvendësi i tij;
- udhëheqësi i njësisë organizative për burime njerëzore, përkatësisht nëpunësi administrativ i cili kryen punët që kanë të bëjnë me menaxhimin e burimeve njerëzore dhe zëvendësi i tij;
- punonjës në ndërmarrjen publike me statusin e ofruesit të shërbimit publik dhe zëvendësi i tij.

(3) Si përjashtim nga paragrafi (2) i këtij neni, në njësinë organizative në të cilën nuk ka ofrues udhëheqës të shërbimit publik, Komisioni përbëhet nga cilët do qofshin punonjës me statusin e ofruesve të shërbimeve publike nga ndërmarrja publike.

Neni 7

(1) Procedura e përzgjedhjes për punësimin e ofruesve të shërbimeve publike në ndërmarrjen publike përbëhet nga tri faza, edhe atë: verifikimi i të dhënave të futura në paraqitjen për punësim me kushtet e përcaktuara në shpalljen publike, verifikimi i dëshmimeve të bashkëngjitura me paraqitjen dhe intervista.

Neni 8

(1) Pas zbatimit të verifikimit të të dhënave të futura në paraqitjen për punësim me kushtet e përcaktuara në shpalljen publike, Komisioni përpilon procesverbal.

(2) Së bashku me procesverbalin, për secilin vend pune të ndryshëm nga shpallja, bashkëngjiten:

- lista e kandidatëve të rregullt dhe të parregullt, e cila përmban të dhënat e mëposhtme: emrin dhe mbiemrin e secilit prej kandidatëve të rregullt, emrin dhe mbiemrin e çdo kandidati të parregullt dhe arsyen e parregullsisë së tij, si dhe lista e kandidatëve që vazhdojnë në fazën e dytë - verifikimi i dëshmimeve të bashkëngjitura me paraqitjen.

(3) Verifikimi i kryer i të dhënave të futura në paraqitjen për punësim me kushtet e përcaktuara në shpalljen publike përfundon më së voni në afat prej 10 ditësh pas skadimit të afatit për paraqitjen e kandidatëve në shpalljen publike.

Neni 9

(1) Më së voni në afat prej 10 ditësh nga verifikimi i kryer i të dhënave të futura në paraqitjen për punësim, Komisioni i përzgjedhjes bën verifikimin e dëshmimeve të bashkëngjitura me paraqitjen për çdo vend pune dhe për çdo kandidat dhe për të njëjtën gjë përpilon Procesverbal në të cilin caktohet koha e zhvillimit të intervistës.

Neni 10

(1) Intervistimi i kandidatëve për punësim në vendin e punës bëhet nga ana e Komisionit, më së voni në afat prej 10 ditësh nga verifikimi i dëshmimeve të bashkëngjitura me paraqitjen.

(2) Për ditën, orën dhe vendin e zhvillimit të intervistës, kandidatët njoftohen në rrugë elektronike ose përmes telefonit.

(3) Në intervistë mund të bëhen pyetje në formë me gojë, me shkrim ose në kombinim të të dyja formave.

(4) Intervistën e udhëheq kryetari i Komisionit, i cili siguron trajtim të barabartë dhe të drejtë për të gjithë kandidatët.

Neni 11

(1) Në intervistë, përmes pyetjeve situacionale, verifikohen kompetencat e përgjithshme të nevojshme të punës për kategorinë që i përket vendi i punës, kurse përmes pyetjeve profesionale ose detyrave praktike, verifikohen kompetencat e veçanta të punës nga përshkrimi i vendit të punës, si dhe përdorimi aktiv i gjuhës maqedonase.

(2) Pas përfundimit të intervistës, Komisioni përpilon procesverbal në të cilin përfshihet lista e kandidatëve me të cilët është zhvilluar intervista dhe në të cilin përfshihet pikëzimi për njohjen e lëndës nga kompetencat e përgjithshme të punës, kompetencat e veçanta të punës dhe përdorimi aktiv i gjuhës maqedonase, edhe atë:

- për kompetencat e përgjithshme të punës - më së shumti 40 pikë;
- për kompetencat e veçanta të punës - më së shumti 40 pikë;
- për përdorimin aktiv të gjuhës maqedonase - më së shumti 20 pikë.

Neni 12

(1) Në afat prej tri ditësh nga dita e zhvillimit të intervistës, në përputhje me pikët e fituara, Komisioni i përzgjedhjes harton listën përfundimtare të rangimit nga kandidatët e paraqitur.

(2) Komisioni i përzgjedhjes zgjedh kandidatin e ranguar më së miri, në bazë të pikëzimit të kryer, dhe në afat prej tri ditësh ia dorëzon atë drejtorit të Ndërmarrjes Publike për Furnizim me Ujë "Studençica" - Kërçovë.

(3) Në rastin kur në shpalljen publike për punësimin e ofruesit të shërbimit publik në Ndërmarrjen Publike për Furnizim me Ujë "Studençica" - Kërçovë nuk ka të paraqitur asnjë kandidat, shpallja publike përsëritet.

Neni 13

(1) Drejtori i ndërmarrjes publike, në afat prej pesë ditësh pas marrjes së propozimit nga neni 12 i kësaj Rregulloreje, sjell Vendim për përzgjedhje.

(2) Vendimi për përzgjedhje i dorëzohet kandidatit të përzgjedhur dhe publikohet në faqen e internetit dhe në tabelën e shpalljeve të ndërmarrjes publike.

(3) Kundër vendimit nga paragrafi 1 i këtij neni, kandidati i pakënaqur ka të drejtë që në afat prej tetë ditësh të dorëzojë ankesë pranë Këshillit Drejtues të Ndërmarrjes Publike.

(4) Në afat prej pesë ditësh nga plotfuqishmëria e vendimit për përzgjedhje, drejtori i Ndërmarrjes Publike lidh kontratë pune me kandidatin e përzgjedhur.

Neni 14

(1) Komisioni i përzgjedhjes, në afat prej 5 ditësh pune nga lidhja e kontratës së punës me kandidatin/ët e përzgjedhur, njofton me shkrim kandidatin që nuk është përzgjedhur se nuk është përzgjedhur dhe cili kandidat është përzgjedhur, si dhe ia kthen të gjitha dokumentet që ai ka dorëzuar si dëshmi për plotësimin e kushteve të kërkuara për kryerjen e punës.

Neni 15

(1) Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit të saj.

Këshilli Drejtues

Kryetare,

Irena Ololoska